



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit  
dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 7 shtator 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit  
mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 tetor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit,<sup>2</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi aktakuzën e konfirmuar, me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Aktakuza e Konfirmuar”).<sup>3</sup>

2. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin ku ZPS-ja u urdhërua që të dorëzonte versionin e korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar deri më 3 shtator 2021 (“Vendimi i Parë për Mangësitë”).<sup>4</sup> Më 22 gusht 2022, Gjykata e Apelit konfirmoi Vendimin e Parë për Mangësitë (“Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë”).<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar, në të cilin u korrigjuan disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00045/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00045/A02) dhe të redaktuar publik (F00045/A03). Një version me më pak redakte u dorëzua më 11 dhjetor 2021 (F00134).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 korrik 2021, konfidencial, para. 179(d). Versioni i redaktuar publik i dorëzua më të njëjtën ditë, F00413/RED.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, IA012/F00015, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 gusht 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i dorëzua më të njëjtën ditë, IA012/F00015/RED.

3. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi “Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)”,<sup>6</sup> në të cilin parashtroi edhe aktakuzën e ndryshuar për t’u konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>7</sup>
4. Më 23 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin mbi Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)” në të cilin palët u urdhëruan të paraqesin përgjigjet dhe kundërpërgjigjet e tyre, sipas rastit, ndaj pyetjes nëse materiali mbështetës për ndryshimet që konsideroheshin se përbëjnë akuza të reja, mbështet konstatimin e dyshimit të bazuar mirë sipas rregullës 86(4) të Rregullores.<sup>8</sup>
5. Më 22 prill 2022, pasi dëgjoi palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin për konfirmimin e akuzave të reja dhe urdhëroi ZPS-në të dorëzonte, ndër të tjera, aktakuzën e ndryshuar.<sup>9</sup>
6. Më 29 prill 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar (“Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar”).<sup>10</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00455, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesë për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar dhe versioni publik i redaktuar u dorëzuan përkatësisht më 8 shtator 2021, F00455/CONF/RED dhe F00455/RED. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* përfshihet në F00455/A01, me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Versioni konfidencial me më pak redakte i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 17 janar 2022, F00647/A01.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00455/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 8 shtator 2021, F00455/CONF/RED/A02.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00635, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 23 dhjetor 2021, konfidencial, para. 48, 53(d), (e). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 dhjetor 2021, F00635/RED.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00777/CONF/RED. Versioni konfidencial me më pak redakte u dorëzua më 16 maj 2022, F00777/CONF/RED2. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2022, F00777/RED.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00789, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve Lidhur me Të*, 29 prill 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Shtojcat 2-4, konfidenciale, dhe Shtojcat 5-7, publike.

7. Më 22 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht mocionin e Mbrojtjes së z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") që pretendon mangësi në formën e Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar ("Vendimi i Kundërshtuar").<sup>11</sup>
8. Më 19 gusht 2022, Mbrojtja e Thaçit kërkoi leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").<sup>12</sup>
9. Më 31 gusht 2022, ZPS-ja paraqiti përgjigje ndaj Kërkesës ("Përgjigja").<sup>13</sup> Mbrojtja e Thaçit nuk paraqiti kundërpërgjigje.

## II. PARASHTRIMET

10. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me katër pikat në vijim (bashkërisht, "katër pikat"):

- (1) Nëse [Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("GJPP")] gaboi në konstatimin se paraqitja e identitetit të anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale që kryen drejtpërdrejt krimet mbi të cilat bazohen akuzat në paragrafët 68, 93 dhe 174 të Aktakuzës, ishte mjaftueshëm i hollësishëm (dhe rrjedhimisht jo i mangët), duke pasur parasysh detyrimin e prokurorisë për paraqitje të fakteve materiale mbi të cilat bazohet secila prej akuzave ("Pika e Parë");
- (2) Nëse GJPP-ja gaboi në konstatimin se identitetet e viktimave të krimeve të paraqitura në paragrafin 93 të Aktakuzës (pavarësisht ndryshimit të urdhëruar në paragrafin 37 të Vendimit të Kundërshtuar), ishte dhënë me hollësi të mjaftueshme (dhe rrjedhimisht jo i mangët), duke pasur parasysh detyrimin e prokurorisë për paraqitje të fakteve materiale mbi të cilat bazohet secila prej akuzave ("Pika e Dytë");
- (3) Nëse GJPP-ja gaboi në konstatimin se vendi i kryerjes së krimeve të paraqitura në paragrafin 157 të Aktakuzës ishte paraqitur me

---

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 22 korrik 2022, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00931, Mbrojtësi, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 19 gusht 2022, publike. ZPS-ja, nga ana e saj, nuk kërkoi leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar; *shih* KSC-BC-20-06, F00932, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë në lidhje me Vendimin F00895*, 19 gusht 2022, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00942, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit F00895*, 31 gusht 2022, publik.

hollësi të mjaftueshme (dhe rrjedhimisht jo i mangët), duke pasur parasysh detyrimin e prokurorisë për paraqitje të fakteve materiale mbi të cilat bazohet secila prej akuzave (“Pika e Tretë”); dhe

- (4) Nëse GjPP-ja gaboi në konstatimin se të dhëna të tjera për lidhjen e pretenduar të të akuzuarit me krimet e paraqitura në paragrafët 68, 93, 105, 157 dhe 174 të Aktakuzës ishin paraqitur me hollësi të mjaftueshme (dhe rrjedhimisht jo të mangëta), duke pasur parasysh detyrimin e prokurorisë për paraqitje të fakteve materiale mbi të cilat bazohet secila prej akuzave dhe të drejtën e të akuzuarit të njoftohet me kohë për rolin e tij në krimet e pretenduara (“Pika e Katërt”).<sup>14</sup>

11. Mbrojtja e Thaçit parashtron se katër pikat burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk përbëjnë as thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar e as shqetësim hipotetik.<sup>15</sup> Mbrojtja e Thaçit argumenton se katër pikat kanë të bëjnë me të drejtën e të akuzuarit për t’u njoftuar me kohë dhe në hollësi për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij, faktorë këta që në mënyrë të ndjeshme ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>16</sup> Mbrojtja e Thaçit gjithashtu argumenton se një vendim me fuqi detyruese i Gjykatës së Apelit mund të jetë i dobishëm për aspektet e saktësisë dhe qartësisë së një aktakuze, sa më herët që të jetë e mundur.<sup>17</sup>

12. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë meqë nuk përmbush kriteret për leje për apelim sipas nenit 45 të Ligjit dhe rregullës 77 të Rregullores.<sup>18</sup> ZPS-ja argumenton se katër pikat kanë të bëjnë me standardet për argumentim të aktakuzës, e që Gjykata e Apelit tanimë i ka trajtuar në kontekstin e kësaj çështjeje gjyqësore.<sup>19</sup> ZPS-ja pretendon se Mbrojtja nuk ka dhënë argumente në lidhje me zhvillimin e shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit, dhe as nëse pikat do të avanconin

---

<sup>14</sup> Kërkesa, para. 19.

<sup>15</sup> Kërkesa, para. 20.

<sup>16</sup> Kërkesa, para. 22.

<sup>17</sup> Kërkesa, para. 23.

<sup>18</sup> Përgjigja, para.1, 6.

<sup>19</sup> Përgjigja, para.1-2.

thelbësisht procesin, duke marrë parasysh se Gjykata e Apelit ka marrë vendim me fuqi detyruese dhe përsëritja e procedurës së apelit në lidhje me këto pika vetëm do të paraqisnin rrezik për shtyrje dhe ndërprerje.<sup>20</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Sipas nenit 45 të Ligjit, apelet e ndërmjetme, të paraqitura nga i akuzuari apo nga ZPS-ja në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, shqyrtohen nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë vetvetiu të lejueshëm, duhet të miratohet leje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues mbi bazën se kanë të bëjnë me çështje që do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilat, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykues, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

14. Rregulla 77(2) e Rregullores përcakton më tej se Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

### IV. DISKUTIM

15. E drejta e apelit lind vetëm nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel, i përcaktuar në nenin 45(2) të

---

<sup>20</sup> Përgjigja, para.4-5.



Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores.<sup>21</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton interpretimin e këtyre dispozitave të përcaktuara në hollësi më parë.<sup>22</sup>

16. Duke pasur parasysh llojin kufizues të këtij mjetei juridik, zbatohen kriteret në vijim:

1. Nëse pika e ngritur përbën “pikë të apelueshme”;
2. Nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm në:
  - (1) kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose
  - (2) rezultatit e gjykimit; dhe
3. Nëse, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.<sup>23</sup>

#### A. PIKA E PARË

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se konkretësia e paraqitjes së anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale që kryen drejtpërdrejt krimet mbi të cilat bazohen akuzat e reja përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.<sup>24</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht gjykon se pika e parë është pikë e apelueshme.

18. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe rezultatit të gjykimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se pika e parë përsërit fjalë për fjalë arsyen e mëparshme të apelit të Mbrojtjes së Thaçit të ngritur në lidhje me apelin e vet kundër Vendimit të Parë për Mangësitë.<sup>25</sup> Ndonëse pika e parë

---

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel* (“Vendimi për Leje për Apelin e Thaçit”), 11 janar 2021, publik, para. 9.

<sup>22</sup> Vendimi për Leje për Apelin e Thaçit, para.10-17.

<sup>23</sup> Vendimi për Leje për Apelin e Thaçit, para. 10.

<sup>24</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para.26, 27, 30, 47.

<sup>25</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 11(t), 64, 146.

ka të bëjë me paragrafë të ndryshëm të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, konkretisht paragrafët 68, 93 dhe 174, parimet që duhet zbatuar mbeten të njëjta.<sup>26</sup> Në veçanti, Gjykata e Apelit konfirmoi që Mbrojtjes i është dhënë njoftim i mjaftueshëm, në rastet kur krahas identifikimit sipas kategorisë, kryesit janë saktësuar në ata që pretendohet se ishin të pranishëm gjatë ngjarjeve konkrete, sikurse përcaktohet prej parametrave kohorë dhe gjeografikë të dhënë aty.<sup>27</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se miratimi i lejes për apelim të pikës së parë do të rezultonte në përsëritje të procedurës së apelit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit nuk ka treguar se si pika e parë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe rezultatin e gjyqimit.

19. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteri tjetër i standardit të miratimit që lind nga neni 45(2) i Ligjit dhe rregulla 77(2) e Rregullores nuk ka nevojë të trajtohet. Për këtë arsye, refuzohet leja për apelim të pikës së parë.

## B. PIKA E DYTË

20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, sikurse u shpjegua në Vendimin e Kundërshtuar,<sup>28</sup> ndryshimi në paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar ka të bëjë me shtimin e vetëm një viktime, emri i të cilit/cilës u urdhërua që të shtohet prej ZPS-së, edhe pse, në parim, ishte dhënë informacion i hollësishëm.<sup>29</sup> Emrat e viktimave të tjera të përmendura në atë paragraf nuk ishin pjesë e vlerësimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Kundërshtuar dhe, rrjedhimisht,

---

<sup>26</sup> *Krahaso* Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 72-73, 76-77 me Vendimi i Kundërshtuar, para.24-31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake qartësoi në para. 27 të Vendimit të Kundërshtuar se Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar përmend konkretisht grupin e kryesve dhe përkatësinë e tyre (Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68), njësitin konkret (Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68), shtabin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") (Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar para. 93) dhe parametrat kohorë dhe gjeografikë (Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 174).

<sup>27</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 77.

<sup>28</sup> *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 37.

<sup>29</sup> *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para.35, 38.



tani nuk mund të kundërshtohen nga Mbrojtja e Thaçit. Bazuar në këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pika e dytë nuk është pikë e apelueshme, sepse nuk lind nga Vendimi i Kundërshtuar.

21. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit që lindin nga neni 45(2) i Ligjit dhe rregulla 77(2) e Rregullores nuk ka nevojë të trajtohen. Për këtë arsye, refuzohet leja për apelim të pikës së dytë.

### C. PIKA E TRETË

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se konkretësia e paraqitjes së vendit të kryerjes së krimeve të pretenduara mbi të cilat bazohen akuzat e reja përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.<sup>30</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pika e tretë është pikë e apelueshme.

23. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatit të gjykimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se pika e tretë përsërit fjalë për fjalë arsyen e mëparshme të apelit të Mbrojtjes së Thaçit të ngritur në lidhje me apelin e vet kundër Vendimit të Parë për Mangësitë.<sup>31</sup> Ndonëse pika e tretë ka të bëjë me një paragraf tjetër në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar, konkretisht paragrafin 157, parimet që duhet zbatuar mbeten të njëjta.<sup>32</sup> Në veçanti, Gjykata e Apelit konfirmoi se shkalla e konkretësisë për vendndodhjen e paraqitur varet nga lloji i akuzave të ngritura prej ZPS-së dhe nuk mund të jetë e njëjtë me shkallën e konkretësisë së provave mbështetëse mbi të cilat bazohen akuzat.<sup>33</sup> Gjykata e Apelit gjithashtu konfirmoi se, vendndodhja në të cilën ose nga e cila pretendohet se janë

---

<sup>30</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para.41-43.

<sup>31</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para.11(v), 152.

<sup>32</sup> *Krahaso* Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 152 *me* Vendimi i Kundërshtuar, para. 41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake qartësoi në para. 41 të Vendimit të Kundërshtuar se Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar konkretisht përmend fshatin përkatës ose komunën dhe brigadat dhe zonën operative të UÇK-së që lidheshin me të (Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar, para. 157).

<sup>33</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 152.

transferuar personat e ndaluar në qendër konkrete ndalimi, nuk përbën fakt material që duhet të paraqitet në Aktakuzë.<sup>34</sup> Gjykata e Apelit nxori përfundimin se për arsye se vendndodhjet e paraqitura, ishin identifikuar sipas qytetit ose fshatit, nuk ka nevojë për hollësi të mëtejshme duke pasur parasysh: (i) informacionin e hollësishëm që është dhënë në lidhje me vendndodhjen e saktë të krimit të pretenduar, kur ishte i mundshëm; (ii) llojin dhe shkallën e krimeve në aktakuzë; dhe (iii) faktin që të akuzuarit nuk akuzohen për kryerjen fizike të asnjë prej krimeve të pretenduara.<sup>35</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se miratimi i lejes për apelim të pikës së tretë do të rezultonte në përsëritje të procedurës së apelit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit nuk ka treguar se në çfarë mënyre pika e tretë do të ndikonte në kryerjen e shpejtë dhe të drejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.

24. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit që lindin nga neni 45(2) i Ligjit dhe rregulla 77(2) e Rregullores nuk ka nevojë të trajtohen. Për këtë arsye, refuzohet leja për apelim të pikës së tretë.

#### D. PIKA E KATËRT

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se konkretësia e argumentimit të lidhjes së pretenduar të të akuzuarit me krimet e pretenduara mbi të cilat bazohen akuzat e reja përbën temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.<sup>36</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se pika e katërt është pikë e apelueshme.

26. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se pika e katërt

---

<sup>34</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 152.

<sup>35</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 152.

<sup>36</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46.

përsërit fjalë për fjalë arsye e mëparshme të apelit të Mbrojtjes së Thaçit të ngritur në lidhje me apelin e vet kundër Vendimit të Parë për Mangësitë.<sup>37</sup> Ndonëse pika e katërt ka të bëjë me paragrafë të tjerë të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, konkretisht paragrafët 68, 93, 105, 157 dhe 174, parimet që duhen zbatuar mbeten të njëjta.<sup>38</sup> Në veçanti, Gjykata e Apelit konfirmoi, se lidhja e të akuzuarit me krimet në aktakuzë argumentohet përmes formave të përgjegjesisë penale dhe duke pasur parasysh se sjellja e të akuzuarit që pretendohet se rezultoi në përgjegjësi penale argumentohet mjaftueshëm përmes këtyre formave të përgjegjesisë, çdo informacion shtesë për lidhjen e të akuzuarit me krimet në aktakuzë dhe/ose rolin e tij në to nuk do të përbënin fakte materiale që duhet të përfshihen në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar, por aspekte provash që duhet të trajtohen gjatë gjykimit.<sup>39</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se miratimi i lejes për apel të pikës së katërt do të rezultonte në përsëritje të procedurës së apelit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit nuk ka treguar se në çfarë mënyre pika e katërt do të ndikonte në kryerjen e shpejtë dhe të drejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.

27. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit që lindin nga neni 45(2) i Ligjit dhe rregulla 77(2) e Rregullores nuk ka nevojë të trajtohen. Për këtë arsye, refuzohet leja për apelim të pikës së katërt.

---

<sup>37</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para.11(x), 158-159.

<sup>38</sup> *Krahaso* Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para.158-159 *me* Vendimi i Kundërshtuar, para. 46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaroi në paragrafin 46 të Vendimit të Kundërshtuar se për argumentimin e formave të përgjegjesisë penale nuk është i nevojshëm roli i drejtpërdrejt në kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë dhe vlerësoi se lidhja e z. Thaçi me krimet e paraqitura në aktakuzë, sikurse përcaktohen në paragrafët 68, 93, 105, 157 dhe 174 të Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar , vërtetohet përmes kontributit të tij në qëllimin e përbashkët, ndihmës, inkurajimit ose mbështetjes morale, dhe mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimeve dhe ndëshkimin e kryesve.

<sup>39</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Vendimin e Parë për Mangësitë, para. 158.

V. VENDIM

28. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

**REFUZON** lejen për apelim të katër pikave.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 7 shtator 2022

Hagë, Holandë.